



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më	14.11.2024
Nr.	3238

Data: 12.11.2024

Nr: 13

Ora: 15:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROCEDURËN E VOTIMIT NGA JASHTË
VENDIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 21, datë 20.3.2025 të Komisionit Rregullator)

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 24, pika 5, nenit 25/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

VENDOSI:

KREU I. Parime të përgjithshme

1. Parimi i barazisë së votës: Vota e shtetasve shqiptarë që votojnë jashtë vendit është e barabartë me votën e shtetasve shqiptarë që votojnë brenda vendit.
2. Parimi i lirisë së votës: Shtetasit shqiptarë që votojnë jashtë vendit janë të lirë të zgjedhin sipas dëshirës dhe vlerësimit të tyre.
3. Parimi i garantimit dhe sigurisë së votës: Vota e zgjedhësve nga jashtë vendit është e sigurtë dhe e garantuar. Garantimi dhe siguria e votës janë elementë thelbësore në procesin zgjedhor. Këto elementë realizohen përmes respektimit të ligjit dhe instrumentave administrativo- ligjorë të kontrollit dhe kanë si qëllim të parandalojnë çdo pengim, manipulim apo ndërhyrje të paligjshme në ushtrimin e së drejtës të votimit nga jashtë.
4. Parimi i fshehtësisë së votës: vota e çdo zgjedhësi nga jashtë është e fshehtë dhe paprekshme. Asnjë palë e tretë nuk duhet dhe nuk mund të ndërhyjë për të cënuar votën e zgjedhësit nga jashtë.
5. Parimi i transparencës: rregullat për procedurën e votimit nga jashtë do të jenë baza për auditim të plotë e pa kufizim, në çdo fazë të procesit të votimit të zgjedhësve nga jashtë.

Data: 12.11.2024 Nr: 13



“Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”

6. Parimi i diskrecionit: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka të drejtën të veprojë me diskrecion brenda limiteve të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, me qëllim garantimin, sigurimin dhe mbrojtjen e votës së shtetasve shqiptarë jashtë vendit. Diskrecioni ushtrohet me qëllim që të përmirësohen proceset dhe të garantohet e drejta e votës nga jashtë vendit, të rritet objektiviteti i tyre dhe nivelet e kontrollit, duke adresuar dhe zgjidhur situata eventuale të paparashikuara.

KREU II. Rregulla të përgjithshme

1. Të drejtën e votës nga jashtë vendit e ka çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, emri i të cilit gjendet në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë dhe që në PER ka ngarkuar një dokument identifikimi të vlefshëm përpara miratimit të kësaj liste.
2. Fleta e votimit nga jashtë vendit është për çdo zonë zgjedhore, e njëjtë me fletën e votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por me një element të veçantë dallues.
3. Fletët e votimit prodhohen për çdo zonë zgjedhore dhe numri i tyre është i barabartë me numrin e zgjedhësve në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë duke i shtuar 2 për qind, për çdo zonë zgjedhore. Në rast se gjatë përgatitjes së dokumentacionit zgjedhor nga personeli përkatës i KQZ dëmtohet një fletë votimi, ajo zëvendësohet me një fletë votimi tjetër nga kontigjenti rezervë prej 2%. Me këtë rast nga ky personel mbahet një procesverbal i cili depozitohet menjëherë në protokollin e KQZ-së.
4. Fletët e votimit të papërdorura futen në një apo disa kuti të cilat mbyllen me vula me kode sigurie. Procesverbali për mbylljen e kutisë/kutive depozitohet në protokollin e KQZ-së dhe kopje të tij, me kërkesë, marrin përfaqësuesit e partive politike në KQZ, si dhe vëzhguesit e akredituar në KQZ.
5. Votimi nga jashtë vendit quhet i çelur nga dita që KQZ nis procedurat për dërgimin e dokumentacionit zgjedhor të votimit dhe dokumentacionit udhëzues në adresë të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe mbyllet në ditën e votimit, në orën e caktuar nga Kodi Zgjedhor për mbylljen e votimit në qendrat e votimit.

KREU III. Rregulla të posaçme

III.1. Dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit jashtë vendit

(Ndryshuar pika 1, shtuar shkronja “dh” dhe ndryshuar pika 3, me vendimin nr. 21, datë 20.3.2025 të Komisionit Rregullator)

1. Dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë me zarfin e operatorit të shërbimit postar përmban:
 - a) Fletën e votimit;
 - b) Zarfin ku futet fleta e votimit;

- c) Material udhëzues që përmban sqarime për zgjedhësin për plotësimin e fletës së votimit, sqarime për procedurat e dërgimit mbrapsht të fletës së votimit nga zgjedhësi tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe informacione të tjera që lidhen me procesin e votimit.
 - d) Zarfën e jashtëm ku vendoset zarfi që përmban fletën e votimit.
 - dh) Zarfën e kthimit të operatorit të shërbimit postar.
2. Zarfi ku futet fleta e votimit është në përmasa dhe në ngjyrë të njëjtë për të gjithë zgjedhësit.
 3. Dokumentacioni zgjedhor që i dërgohet zgjedhësit nga jashtë përgatitet nga KQZ. Fleta e votimit nga jashtë duhet të vuloset nga ana e pasme me një vulë të posaçme për çdo qark. Pas vulosjes, fleta e votimit nga jashtë futet në zarfin e fletës së votimit. Vulosja bëhet nga një person i autorizuar nga KQZ. Përpara fillimit të procesit të vulosjes së fletëve të votimit, bëhet vulosja e një flete të bardhë (format A4) për çdo qark me vulën përkatëse. Çdonjëra prej fletëve të bardha që është vulosur me vulën e qarkut përkatës nënshkruhet nga personi i autorizuar nga KQZ, si dhe nga përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje dhe që shprehin vullnetin për të kryer këtë proces. Fletët e bardha të nënshkruara dhe vulosura si më sipër ruhen në protokollin e KQZ.

III.2. Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor tek zgjedhësi

(Ndryshuar pika 3, me vendimin nr. 21, datë 20.3.2025 të Komisionit Rregullator)

1. Dokumentacioni zgjedhor i përgatitur sipas seksionit III.1 i dërgohet zgjedhësit nga jashtë në mënyrë individuale.
2. Dokumentacioni zgjedhor për votimin nga jashtë i dërgohet zgjedhësit në adresën e deklaruar në PER nga vetë zgjedhësi.
3. Dërgimi i dokumentacionit zgjedhor bëhet nëpërmjet një shërbimi postar ekspres që mundëson gjurmimin e dërgesës.
4. Operatori i përzgjedhur i shërbimit postar ka detyrimin për raportimin në mënyrë periodike ditore mbi dërgesat e dokumentacionit zgjedhor. Nëse operatori i shërbimit postar nuk ka mundur të dorëzojë tek zgjedhësi dokumentacionin zgjedhor, atëherë ky operator ka detyrimin të njoftojë menjëherë dhe t'i kthejë KQZ-së dokumentacionin zgjedhor përkatës.

III.3. Votimi dhe dërgimi i dokumentacionit zgjedhor në KQZ nga zgjedhësi

(Ndryshuar pikat 1, 4 dhe 6, me vendimin nr. 21, datë 20.3.2025 të Komisionit Rregullator)

1. Zgjedhësi, të cilit i ka mbërritur dokumentacioni zgjedhor nga KQZ mund të konfirmojë për marrjen në dorë të këtij dokumentacioni nëpërmjet llogarisë së tij në PER. Zgjedhësi plotëson fletën e votimit duke bërë shënimin përkatës sipas udhëzimeve të dërguara nga KQZ. Plotësimi i fletës së votimit bëhet në mënyrë individuale.
2. Pasi plotëson fletën e votimit, zgjedhësi e vendos atë në zarfin e fletës së votimit të dërguar nga KQZ. Në zarfin e fletës së votimit vendoset/futet vetëm fleta e votimit dhe asnjë dokument tjetër.
3. Nuk lejohet asnjë lloj shënimi mbi zarfin e fletës së votimit.

4. Zarf i fletës së votimit, i cili përmban vetëm fletën e votimit, vendoset në zarfin e jashtëm të dërguar tek zgjedhësi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve sipas parashikimeve të kreut III.1, të këtij vendimi. KQZ do të vendosë mbi këtë zarf vetëm emrin e shtetit ku do të dërgohet fleta e votimit, si dhe qarkun ku zgjedhësi të cilit i dërgohet fleta e votimit, ka regjistrin e gjendjes civile. Mbi këtë zarf vendoset edhe një QR Code, ose Barcode i cili përbën Kodin Unik të zgjedhësit dhe që përmban veçmas emrit të shtetit ku do të dërgohet fleta e votimit, emrin e qarkut ku zgjedhësi të cilit i dërgohet fleta e votimit ka regjistrin e gjendjes civile edhe emrin e mbiemrin e vetë zgjedhësit, si dhe numrin e kërkesës bërë në PER për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve nga jashtë. Përmbajtja e QR Code, ose sipas rastit e Barcode janë të palexueshme nga të tretë, por vetëm nga KQZ.
5. Zarf i jashtëm mbi të cilin është vendosur Kodi Unik i zgjedhësit i cili ka brenda zarfin që mban fletën e votimit, futet në zarfin e operatorit të shërbimit postar dhe postohet për në adresën e KQZ.
6. Zgjedhësi duhet të kujdeset që dërgimi i dokumentacionit zgjedhor për në KQZ të bëhet brenda një afati të rekomanduar në materialin udhëzuesin që dërgohet nga KQZ sipas shkronjës “c”, të pikës 1 të ndarjes III.1 të Kreut III të këtij vendimi.

III.4. Ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit zgjedhor të dërguar nga zgjedhësi nga momenti i mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në fillimin e numërimit dhe të vlerësimit të votave nga jashtë

(Ndryshuar pikat 4, 7, 9, 10, 16 dhe shtuar pika 17 me vendimin nr. 21, datë 20.3.2025 të Komisionit Rregullator)

1. Operatori i shërbimit postar i cili administron brenda vendit dokumentacionin zgjedhor të dërguar nga zgjedhësi nga jashtë e të mbërritur në territorin e Republikës së Shqipërisë, i administron dërgesat në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe me aktet për votimin nga jashtë të miratuara nga KQZ.
2. Operatori i shërbimit postar ka detyrimin që pritja, grumbullimi dhe ruajtja e dokumentacionit zgjedhor nga momenti i mbërritjes në Republikën e Shqipërisë deri në dërgimin e këtij dokumentacioni në KQZ duhet të bëhet në një ambient të posacëm i cili duhet të ketë shërbim të monitorimit me kamera. Regjistrimet e këtij monitorimi ruhen në përputhje me parashikimet ligjore përkatëse, por në cdo rast deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Me kërkesë, subjekteve zgjedhore u vihet në dispozicion një kopje e regjistrimeve të këtij monitorimi.
3. Operatori i shërbimit postar shënon në një regjistër të posacëm të gjitha të dhënat mbi dërgesat e dokumentacionit zgjedhor, si të tilla, por jo vetëm, emër dhe mbiemër të dërguesit, shtetin, si dhe datën dhe orën e mbërritjes.
4. Çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të caktojë një mbikëqyrës të procesit qarkullimit të dokumentacionit zgjedhor që nga momenti i mbërritjes në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në dorëzimin e tij në KQZ. Mbikëqyrësi i caktuar nga subjekti zgjedhor ka të drejtë të jetë prezent fizikisht në ambientet e doganës, të operatorit të shërbimit postar ku priten dhe administrohen dërgesat postare në të cilat bartet dokumentacion zgjedhor i

- votimit nga jashtë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pajis mbikëqyrësit me autorizimin përkatës në bazë të kërkesave të subjekteve zgjedhore. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendim, përcakton të drejtat dhe detyrat e mbikëqyrësit.
5. Operatori i shërbimit postar ka detyrimin e dorëzimit në KQZ të dokumentacionit zgjedhor të paktën dy herë brenda 24 orëve. Me këtë rast midis KQZ dhe operatorit të shërbimit postar mbahet një procesverbal marrje në dorëzim të materialit zgjedhor. Dorëzimi të bëhet në ambientet e KQZ -së.
 6. KQZ ruan dhe administron dokumentacionin zgjedhor të marrë në dorëzim nga operatori i shërbimit postar në një ambient të vecantë, të sigurtë dhe të paaksesueshëm nga persona të paautorizuar i cili monitorohet me kamera. Partitë politike të cilat kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ kanë të drejtë të caktojnë mbikëqyrës ose monitorues të ambientit ku KQZ ruan/administron dokumentacionin zgjedhor. Ambienti në fjalë mund të vëzhgohet pa asnjë kufizim edhe nga vëzhgues të tjerë të regjistruar në KQZ. Regjistrimet e kamerave ruhen dhe një kopje e tyre i vihet në dispozicion me kërkesë çdo subjekti zgjedhor.
 7. Pasi ka marrë në dorëzim zarfin e shërbimit postar, KQZ e hap atë dhe lexon fillimisht të dhënat e Kodit Unik që përmban zarfi që gjendet brenda zarfit të shërbimit postar. Këto të dhëna shënohen në një regjistër të posaçëm (fizik/elektronik). Në këtë regjistër shënohet ora dhe data e regjistrimit të këtyre të dhënave. Në rast se kur hapet zarfi i shërbimit postar konstatohet se mungon zarfi i jashtëm që përmban Kodin Unik ose Kodi Unik nuk gjendet në këtë zarf apo është i dëmtuar ose i palexueshëm, atëherë KQZ e vendos këtë dokumentacion zgjedhor në një zarf plastik dhe shënon të dhënat e zarfit të operatorit të shërbimit postar në regjistrin e posaçëm (fizik/elektronik).
 8. Menjëherë pas regjistrimit në këtë regjistër, KQZ njofton zgjedhësin në llogarinë e tij në PER se zarfi me materialet zgjedhore i mbërritur u administrua në KQZ dhe se do të vlerësohet në afatin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor.
 9. Zarfi që përmban Kodin Unik shkëputet nga zarfi i shërbimit postar dhe futet në kutinë përkatëse të votimit nga jashtë, e cila është e ngjashme në funksionalitet me kutinë e votimit që përdoret për votimin në qendrën e votimit. Në rast se kur hapet zarfi i shërbimit postar konstatohet se mungon zarfi i jashtëm që përmban Kodin Unik ose Kodi Unik nuk gjendet në këtë zarf apo është i dëmtuar ose i palexueshëm, KQZ fut në kutinë përkatëse të votimit nga jashtë këtë dokumentacion zgjedhor brenda një zarfi plastik. Zarfat e shërbimit postar ruhen nga KQZ deri në përfundim të procesit zgjedhor dhe të dhënat e tyre shënohen në regjistrin e zarfave të shërbimit postar.
 10. Dokumentacioni zgjedhor i zgjedhësve nga jashtë i mbërritur në KQZ administrohet në kuti të ndryshme të cilat për nga karakteristikat teknike e fizike, si dhe funksionaliteti janë të njëjta me kutinë e votimit brenda vendit. KQZ duhet të bëjë indeksimin e çdo kutie. Kutitë indeksohen me kod të përbërë nga gërma dhe shifra. Ky kodifikim përbëhet nga këta tre element/sesione: ku dy karakteret e para përmbajnë dy gërmat e para të emërtesës së qarkut; karakteri i radhës do të lidhet me llojin e kutisë së votimit nga jashtë: përkatësisht a (për kutinë e votimit nga jashtë; b- për kutinë e posaçme të votimit nga jashtë; c – për kutinë rezervë të votimit nga jashtë dhe ç – për kutinë e posaçme rezervë të votimit nga jashtë) dhe 3 karakteret e fundit janë numra treshifrorë që pasojnë në rend rritës nga “001” deri

“999”. Numërtimi është i mëvetësishëm për çdo qark. Tre elementët/sesionet e sistemit të kodifikimit të kutive të votimit nga jashtë, ndahen nga njëri-tjetri nga karakteri ndarës “/”. Numri i indeksit vendoset në njërën prej faqeve anësore të çdo Kutie. Administrimi i dokumentacionit zgjedhor të votuesve nga jashtë bëhet mbi bazë qarku.

11. Kutia e votimit nga jashtë është e tejdukshme nga të paktën katër anët e saj. Kjo kuti duhet të mbyllet me kapak i cili lidhet me kutinë me jo më pak se 4 vula me kode sigurie. Kapaku duhet të ketë një të çarë nëpërmjet të cilës të mund të futet dokumentacioni zgjedhor i ardhur nga jashtë, por njëkohësisht kjo e çarë nuk duhet të lejojë nxjerrjen e këtij dokumentacioni. E çara në kapakun e kutisë së votimit nga jashtë duhet të mundësojë funksionalitetin e mbylljes me vulë me kod sigurie.
12. Përpara depozitimit të dokumentacionit zgjedhor në kutinë e votimit nga jashtë, mbyllja e saj me kapakun përkatës bëhet nga KQZ publikisht në prani të përfaqësuesve të partive politike, të medias dhe të organizatave të shoqërisë civile që vëzhgojnë procesin zgjedhor. KQZ shënon në një procesverbal kodet e vulave të sigurisë me të cilën mbyllet cdo kuti e votimit nga jashtë. Subjektet zgjedhore si dhe vëzhgues kanë të drejtë të marrin kopje të këtij procesverbali.
13. Dokumentacioni zgjedhor i mbërritur i cili është depozituar në kutinë përkatëse të votimit nga jashtë, ruhet në këtë kuti deri në fillimin e procedurave përkatëse të numërimit për qarkun përkatës.
14. Nëse pas hapjes së zarfit të shërbimit postar rezulton se mungon zarfi që përmban Kodin Unik të zgjedhësit, ose në zarfin që duhet të ishte vendosur/ngjitur Kodi Unik, mungon ky i fundit, apo në tërësi dokumentacioni zgjedhor nuk është në përputhje me parashikimet e seksionit III.3 të këtij vendimi, atëherë KQZ mban një procesverbal. Në këtë rast dokumentacioni zgjedhor i këtij zgjedhësi vendoset në një kuti të Posaçme të votimit nga jashtë.
15. Në përfundim të procesit të votimit brenda vendit, KQZ në prani të përfaqësuesve të partive politike dhe të vëzhguesve, mbyll kutitë e votimit nga jashtë si dhe kutinë e posaçme duke shënuar në procesverbal kodin e vulës së sigurisë me të cilën mbyllet kutia përkatëse si dhe numrin e zgjedhësve dokumentacioni zgjedhor i të cilëve është depozituar respektivisht në to.
16. Nëse shërbimi postar depoziton në KQZ dokumentacion zgjedhor të zgjedhësve nga jashtë pas orës 19.00 të ditës së votimit dhe jo më vonë se 24 orë pas këtij momenti, atëherë KQZ e regjistron këtë dokumentacion sipas rregullave të përcaktuara në këtë kre dhe depoziton dokumentacionin zgjedhor në një kuti votimi nga jashtë rezervë të qarkut përkatës. Nëse janë në kushtet e pikës 14 të këtij kreu, atëherë KQZ e depoziton dokumentacionin përkatës zgjedhor në kutinë e posaçme rezervë të votimit nga jashtë.
17. Nëse shërbimi postar depoziton në KQZ dokumentacion zgjedhor të zgjedhësve nga jashtë të mbërritur në territorin e Republikës së Shqipërisë pas orës 19.00 të ditës së votimit, atëherë KQZ e regjistron këtë dokumentacion në regjistrin e posaçëm të dokumentacionit zgjedhor të mbërritur pas orës 19.00 të ditës së votimit dhe e depoziton atë në një kuti për ruajtje. Ky dokumentacion zgjedhor nuk i nënshtrohet vlerësimit.

KREU IV. Monitorimi dhe mbikqyrja e procesit

1. Me qëllim integritetin dhe garantimin e votës nga jashtë vendit, përfaqësuesit e partive politike, organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushën e të drejtave të njeriut dhe/ose zgjedhjeve, media, apo palë të tjera me interes të ligjshëm në këtë proces, kanë të drejtë të mbikqyrin çdo aspekt, në çdo kohë dhe çdo fazë të proceseve të rregulluar nga ky vendim dhe akte të tjera të KQZ.

KREU V. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, me zbatimin e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**